- Edhe punonjësit e shërbimit telefonik të zyrës sonë qendrore të Budapestit ju informojnë rreth pikëve tuaja aktuale të qarkullimit. **Vlerat e pikëve të tyre personale** distributorët e Budapestit mund t'i pyesin në numrin e telefonit +36-1-269-53-70 dhe +36-1-269-53-71, kurse të Kroacisë, Bosnia-Hercegovinës, Sllovenisë, Serbisë dhe Malit të Zi +36-1-322-55-41. Ju lutemi bashkëpunojnësve tanë të interesohen vetë për pikët dhe biznesin e tyre personal!

Informacione nga interneti: Njoftojmë shpërndarësit tanë të dashur se mund të marrin informacione nga dy faqe interneti të kompanisë sonë. Njëra faqe interneti "[www.flpseeu.com](http://www.flpseeu.com)" është faqja kompanisë së vendit tonë, nëpërmjet të cilës mund të arrihen magazinat e vendit tonë. Kodet për të hyrë në këtë faqe dhe për të bërë blerje mund t'i kërkonit në zyrat tona.

Faqja kryesore e internetit të kompanisë, apo siç quhet zakonisht "faqja amerikane" "[www.foreverliving.com](http://www.foreverliving.com)" përmban informacione rreth lajmeve nga FLP-ja, kontaktimeve ndërkombëtare, si dhe rezultateve të pikëve ditore të punonjësve. Në këtë adresë mund të hyjnë gjithë të interesuarit. Në faqen e distributorit mund të hyni duke klikuar mbi "distributor login". Emri i përdoruesit është numri juaj i distributorit (pa shenjat e ndarjes). Fjalëkalimi gjendet në fund të llogarisë suaj muajore.

I lutemi Shpërndarësve tanë të nderuar, që në të ardhmen ti kushtojnë kujdes plotësisht të saktë të **porosive të produkteve dhe të formularëve të tjerë!** Porositë e produkteve të korrigjuara (emri i porositisë) dhe të panëshkruara, me qëllimin për të shmangur gabimet, nuk mund ti pranojmë. Ju lutemi gjithashtu, të kujdeseni për plotësimin e saktë dhe të lexueshëm të formularëve të regjistrimit: me shkronja shtypi, me bojë të zezë ose blu. Në rastin e ndryshimit të adresës apo të emrit, ju lutemi të përdorni formularin e ndryshimit të të dhënave!

Në interes të sigurisë së çështjeve financiare ju lutemi, që në rastin e **paraqitjes së bonuseve** nëpërmjet të besuarit për këtë, ky person i besuar të sjell me vete edhe letërnjoftimin e tij! Sipas politikës ndërkombëtare të biznesit, çdo shpërndarës, që nënshkruan formularin e regjistrimit (kontratën), fiton të drejtën e blerjes së produkteve me çmim shumice, direkt nga zyrat. Gjithashtu, shpërndarës i regjistruar, ai bëhet vetëm gjatë blerjes së parë, duke paraqitur kopjen e dytë të formularit të regjistrimit së plotësuar më parë dhe dokumentin e porosisë së produktit të plotësuar.

**RISPNOSORIZIM!** Dëshiroj t'ju tërheq vëmendjen për rregullat e "risponsorizimit" të cilat gjenden në kapitullin e 12-të të Politikës së Biznesit. E rëndësishme është se risponsorizimi s'është proces automatik, por vjen në fuqi vetëm pas plotësimit të formularëve të përcaktuar (deklarata e risponsorizimit, fletë regjistrimi e re) dhe përgjigjes së kushteve. Në lidhje me rregullat e Politikës së Biznesit gabon ai që bashkëpunonjësit distributor të regjistruar njëherë i fut për herë të dytë pa plotësuar procesin e risponsorizimit.

## **NJOFTIMET E ZYRAVE TË HUNGARISË:**

Njoftojmë Shpërndarësit tanë të nderuar se vendi i organizimit të Success Day Forever të 18 nëntor, që fillon në orën 10, është: Arena Sportive e Budapestit, Budapest, 1143, Stefánia út 2. I mirëpresim të gjithë! Dëshiroj t'iu njoftoj përsëri se magazina jonë në rrugën Nefelejcs është hapur në orarin 17-20.

**Produktet e Forever Living Products dalin në treg me rekomandimin e Shoqatës së Mjeksisë Popullore të Hungarisë.**

**Magazina e FLP-s, Budapest**

I lutemi Shpërndarësve tanë të nderuar, që bashkë me formularin e tyre të regjistrimit të dorëzojnë edhe kopjen e lishencës së tyre, si dhe kopjen e dokumentit të paraqitjes së Zyrës së Taksave dhe Tatimeve të ndërmarrjeve. Ata partnerë të Hungarisë, të cilët për blerjet e bëra dëshirojnë të nxjerrin llogari në emrin e ndërmarrjes së tyre personale, mund ta bëjnë këtë vetëm në rast se dërgojnë dokumentet e duhura të plotësuar, dhe një kopje të dokumentit që vërteton pozitën e tij si pronar i ndërmarrjes. Njoftimi, që ka të bëjë me këtë, është i nxjerrë në zyrat tona, por kolegët tanë mund t'ju njoftojnë edhe me fjalë në këtë aspekt.



**Zyra e Debrecenit**

**Numrat aktual dhe të mëparshëm të revistës mujore mund të lexohen në faqen tonë të internetit duke përdorur passwordin „forever”.**

## **Njoftim rreth mundësisë së blerjes me ulje**

Për të përdorur mundësinë e blerjes me ulje ju lutemi zbatoni rregullat e mëposhtme:

**1/Deklarata:** Ju lutemi që me vëmendje plotësoni saktësisht çdo pjesë të deklaratës. Nëse e dërgoni personalisht kolegët tanë i kontrollojnë të dhënat, por nëse e dërgoni me postë kjo gjë nuk është e mundur, prandaj ju lutemi që me një vëmendje të madhe kontrolloni të dhënat tuaja, sepse në rast gabimi sistemi i uljes së çmimeve nuk hyn në fuqi.

**2/Blerja:** Gjatë blerjes sistemi i ofron shumën maksimale të uljes atyre që e plotësuan deklaratën. Blerja do të thotë përdorimin e uljes së çmimeve ose pagesën e bonusave, kështu edhe blerja personale kërkon letërnjoftim me fotografi. Në rastin e blerjes si grup duhet të sillni autorizim të nënshkruar nga dy dëshmitarë të rregullt nga çdo person, për çdo porosi. Kolegët tanë i pranojnë porositë vetëm pasi i kanë kontrolluar këto



gjëra. Në rastin e personave me deklaratë mungesa e letërnjoftimit apo e autorizimit sjell refuzimin e porosisë!

**3/Informimi:** Kolegët tanë nëpër magazina vetëm pas paraqitjes së letërnjoftimit me fotografi dhe dorëzimit të autorizimeve japin informacione rreth shumës aktuale të uljes.

Bashkëpunonjësit me deklaratë dhe që i marrin bonusat e tyre në formë kuponash, mund të informohen rreth shumave të sakta në adresën Budapest, Szondi u. 34.

**Dëshiroj t'u thërras vëmendjen distributorëve të Hungarisë për shërbimin tonë të transportimit të pakove. Me anë të këtij shërbimi Distributort tanë të Nderuar i marrin porosinë e bëra maksimum brenda 2 ditëve – me përputhje kohe – në çdo pikë të vendit, të cilat duhen marrë brenda 48 orëve, pasi në rast të kundërt ato i anullojmë dhe pikët i zbrisim. Çmimi i produkteve të porositura dhe ai i transportit duhet paguar kur pakoja merret në dorë. Në rastin e blerjes me vlerë mbi 1 pikë shpenzimet e transportit paguhen nga kompania.**

Porosinë tuaja mund t'i bëni në mënyrën e mëposhtme:  
 – në telefon, ku punonjësi ynë ju jep informacione të sakta rreth shumës së porosisë, vlerës së saj në pikë dhe çmimit të transportit.  
 Numrat e telefonit: 061-297-5538, 061-297-5539, cel: 0620/456-8141, 0620/456-8149  
 – nëpërmjet internetit në adresën [www.flpshop.hu](http://www.flpshop.hu),  
 – me sms në numrin e telefonit 0620-478-4732.

### Çmimet e transportit:

	Budapest	Provincë
0-5 kg	640 Ft	1260 Ft
5-10 kg	1240 Ft	1720 Ft
10-30 kg	1520 Ft	1940 Ft
Mbi 30 kg	30 Ft/kg	30 Ft/kg

- Çmimet e mësipërme janë të vlefshme deri në 3 porosi/adresë, mbi 3 porosi llogarisim +200 Ft/porosi.
- Çmimi i postimit është 360 Ft/adresë.
- Siguracioni: deri në shumën 200 000 Ft e përmban çmimi i transportit, mbi këtë shumë për çdo 10 000 Ft është 50 Ft.

Çmimet e mësipërme nuk përmbajnë TVSH-në prej 20%.  
 Transportimi i porosive bëhet pas përputhjes paraprake në telefon.  
 Shpenzimet e përputhjes në telefon përmbahen nga çmimet e mësipërme.

### NJOFTIMET E ZYRAVE TË SERBIË:

Forever Living Products Beograd na ofron shërbimet e mëposhtme: bërje porosish në telefon - telecenter. Të gjitha malltet mund ti porosisni në numrin e telefonit: 011/309-6382. Orari i punës së Telecenterit dhe zyrës së Beogradit: të martën dhe të enjten 12:00-19.30, në ditët e tjera të punës 9:00-16.30. Në rastin e porositjes në telefon malli shkon tek adresa që gjendet në numrin e kodit. Malli paguhet gjatë marrjes së tij.

Shpenzimet e postës paguhen sipas kursit të PTT Serbisë të ditës që ndodh shërbimi. Nuk mund të bëhet hyrje nëpërmjet telefonit. Edhe në zyrën e Horgosit dhe Nisit mund të blihen materiale reklamash dhe gjithë llojet e formularëve. Distributorët tanë mund të blejnë edhe fletat e regjistrimit dhe formularët për ndryshimin e të dhënave. Success Day Forever e ardhshme do të mbahet më 25 nëntor 2006.

### NJOFTIMET E ZYRAVE TË BOSNIA-HERCEGOVINËS:

Në zyrat e Forever Living Products të Bosnias, porosinë telefonike mund të bëhen në numrat e mëposhtëm (regjistrimi i shpërndarësve të rinj nuk mund të bëhet nëpërmjet telefonit):

Bijelina: +387-55-211-784. Orari i hapjes në ditët e punës: 9.00-16.30



**Zyra e Bijelinës**

### Njoftim i zyrës së FLP-s së Sarajevës

Njoftojmë konsumatorët dhe punonjësit tanë të nderuar se adresa e zyrës së Sarajevës është: Akifa Šeremeta do br. 10, 71000 Sarajevo  
 Sarajevo: +387-33-760-650, +387-33-470-682, fax: +387-33-760-651  
 Orari i hapjes: 9:00 – 16:30, çdo të mërkurë: 12:00 – 20:00

Njoftojmë konsumatorët dhe punonjësit tanë të dashur se nga shtatori në shërbimin tonë është këshilltarja dhe specialistja mjeke nga Bosnia-Hercegovina **Dr. Esma Nisic**, me të cilën mund të kontaktohem në numrin e telefonit: +387-62-367-545 gjatë ditëve të punës në orarin: 18:00 – 21:00. Këshilltarja dhe specialistja jonë mjeke çdo të mërkurë mban konsultime në zyrën e Sarajevës në orën 17:00 – 19:00.

Të mërkurën: 12.00-20.00 Në rastin e porosisë telefonike, pagesa bëhet kur merret malli. Nëse vlera e porosisë nuk e kalon vlerën e një pike, atëherë transportimin në shtëpi e paguan shpërndarësi.

Adresa e re e zyrës së Bijeljinës:

FLP-Bos Bijeljina, Trg Đenerala Draže Mihajlovića br. 3, 76300 Bijeljina. Tel: 055/211-784, 055/212-605, fax: 055/221-780.

Adresa e qendrës së Banja Lukës:

Duško Koščica u. 22. Tel: +387-51-228-280, fax: +387-51-228-288



## NJOFTIMET E ZYRËS SË KROACISË:

Njoftojmë konsumatorët dhe distributorët tanë se zyra e FLP-së së Zagrebit gjendet në adresën Grada Mainza 21. Orari i hapjes: të hënën dhe të enjten 12.00-20.00; të martën, të mërkurën dhe të premten 09.00-17.00. Tel.: +385-1-3909-770 dhe fax.: +385-1-3909-771. Porosia telefonike bëhet në numrin +385-1-3909-773. Nëse vlera e porosisë është më e madhe se 1 pikë, shpenzimet e transportit i paguan FLP-ja. Leksionet rreth marketingut dhe produkteve fillojnë çdo të hënë dhe të enjte në orën 18.00 në zyrën qendrore. Ju njoftojmë mëtej se zyra jonë e Splitit gjendet në adresën Križine 19. Tel.: +385-21-459-262. Orari i hapjes: të hënën 12.00-20.00; të martën, të mërkurën, të enjten dhe të premten 09.00-17.00.

## NJOFTIMET E ZYRËS SË SLOVENISË:

Ju njoftojmë se orari i hapjes së magazinës sonë në Trinzi është: të hënën dhe të enjten 12.00-20.00, të martën, të mërkurën dhe të premten 09.00-17.00. Ky orar hapje është i vlefshëm edhe në rastin e porosive telefonike. Numri i Telecenterit (ku bëhen porosinë telefonike) është: 01/563-7501

Adresa e magazinës së Lendvai-t: Kolodvorska 18, 9220 Lendva  
Tel.: +386-40-955-167.



**Zyra e Lendvait**

## Numrat e telefonit të specialistëve tanë mjek të Hungarisë:

Dr. Gabriella Kassai: +36-30-307-7426  
Dr. György Bakanek: +36-20-944-1442  
Dr. Laszlo Kerekes: +36-20-944-1442  
Dr. László Mezösi: +36-20-552-6792.

## Numrat e telefonit të specialistëve tanë mjek të Kroacisë:

Dr. Ljuba Rauski Naglic: +385-915176510  
Dr. Eugenija Sojat Marencic: +385-915107070

## Serbiai orvos szakértőink telefonszáma:

Dr. Biserka Lazarević és Dr. Predrag Lazarević: +381-23-543-318

## Numrat e telefonit të specialistëve tanë mjek të Sllovenisë:

Dr. Arbaiter Miran: +386-41420788  
Dr. Canzek Olga: +386-41824163

## Numrat e telefonit të specialistëve tanë mjek të Malit të Zi:

Dr. Laban Nevenka: +381-69-327-127

# FLP TV

## Në internet

[www.flpseeu.com](http://www.flpseeu.com)

### PROGRAMI

Nga 13 nëntor deri më 10 dhjetor 2006

- 10.00 Lajme
- 5.05 FLP-ja prej 25 vitesh
- 10.20 Holiday Rally – Porec – 2006
- 11.15 Rally European 2006 – Kanë, Niza
- 12.20 Success day – Dr. Adolf L. Kosa
- 12.40 Film prezantues produktesh – Forever Pomesteen
- 12.45 Takim managerësh 2006 – Szirak
- 13.45 Success day – Ibolya Csaszar
- 14.05 Intervistë me Dr. György Bakanek
- 14.30 FLP – Plani Marketing
- 14.45 Success day – Tibor Radoczki
- 15.05 Intervistë me Andrea Gecse
- 15.35 Michael Strachowitz – Si ta fillosh...?
- 16.30 Film prezantues produktesh – Active HA
- 16.35 Nga bima deri tek produkti
- 16.50 Përrallë shampoje
- 16.55 Emil Tonk – Ndërtim biznesi
- 17.20 Film prezantues produktesh – Forever Pomesteen
- 17.25 Tibor Virag – Kjo varet nga...
- 18.00 Lajme
- 18.05 FLP-ja prej 25 vitesh
- 18.20 Holiday Rally – Porec – 2006
- 19.15 Rally European 2006 – Kanë, Niza
- 20.20 Success day – Dr. Adolf L. Kosa
- 20.40 Film prezantues produktesh – Forever Pomesteen
- 20.45 Takim managerësh 2006 – Szirak
- 21.45 Success day – Ibolya Csaszar
- 22.05 Intervistë me Dr. György Bakanek
- 22.30 FLP – Plani Marketing
- 22.45 Success day – Tibor Radoczki
- 23.05 Intervistë me Andrea Gecse
- 23.35 Michael Strachowitz – Si ta fillosh...?
- 00.30 Film prezantues produktesh – Active HA
- 00.35 Nga bima deri tek produkti
- 00.50 Përrallë shampoje
- 00.55 Emil Tonk – Ndërtim biznesi
- 01.20 Film prezantues produktesh – Forever Pomesteen
- 01.25 Tibor Virag – Kjo varet nga...
- 02.00 Lajme
- 02.05 FLP-ja prej 25 vitesh
- 02.20 Holiday Rally – Porec – 2006
- 03.15 Rally European 2006 – Kanë, Niza
- 04.20 Success day – Dr. Adolf L. Kosa
- 04.40 Film prezantues produktesh – Forever Pomesteen
- 04.45 Takim managerësh 2006 – Szirak
- 05.45 Success day – Ibolya Csaszar
- 06.05 Intervistë me Dr. György Bakanek
- 06.30 FLP – Plani Marketing
- 06.45 Success day – Tibor Radoczki
- 07.05 Intervistë me Andrea Gecse
- 07.35 Michael Strachowitz – Si ta fillosh...?
- 08.30 Film prezantues produktesh – Active HA
- 08.35 Nga bima deri tek produkti
- 08.50 Përrallë shampoje
- 08.55 Emil Tonk – Ndërtim biznesi
- 09.20 Film prezantues produktesh – Forever Pomesteen
- 09.25 Tibor Virag – Kjo varet nga...



**Çdo ditë duhet të kaloja në sheshin Kossuth. Turma ishte tepër e madhe dhe dëgjohej shumë zhurmë dhe thërritje.**

**Ecja përpara me frikë duke shmangur me bisht të syrit shtyllat elektrike. Në skenë folësi sapo mbaroi fjalën dhe tregoi nga unë – por çfarë thotë me zërin e tij të çmuar Lui Turi – thërriti. Turma filloi të thërriste në një zë: Lui, Lui, Lui.**

# NGJARJE NGA

**N**uk isha përgatitur për koncert, por dy të rinj të fuqishëm më çuan në podium. Pashë rrotull. Disa qindra mijëra njerëz. E fillova me vështirësi fjalën time.

*Nuk ua kam prezantuar ndonjëherë kaq shumë njerëzve planin marketing të FLP-s.*

Kur mbarova ra një qetësi e madhe. Disa u përpoqën të grindeshin por më të mençurit i thanë të pushonin. Pastaj erdhën përvojat me produkte. Shumë njerëz i kishin përdorur dhe të gjithë kishin mendim pozitiv për produktet.

Mbledhja e nënshkrimeve dhe kërkesa për kartë u bë në mënyrë të organizuar. Bisedën time e dëgjuan shumë vetë edhe nga parlamenti, sepse deputetët erdhën me radhë pavarësisht nga qëndrimi politik. Të gjithë donin të bashkoheshin.

Në mesnatë nuk ra më fjala rreth KDMP-s, SZDSZ-it, MDF-it, Fidesz-it, apo MSZP-s. . . FLP-ja ishte fjala bashkuese. Nxorrën petitionin me titull – *Të mbrojmë kafshët*. Politikanët tanë u qetësuan. Juristët përkufizuan kushtetutën e re;

***Shëndet dhe pavarësi materiale për gjithë shtetin.***

Ky ishte qëllimi. Shumë ministra, ndërmjet tyre edhe kryeministri dhanë vetë dorëheqjen, në mënyrë që të kenë edhe më shumë kohë për arritjen e nivelit të supervisorit.

Në mëngjes u ngrit qeveria e re. Për kryeministër nuk kishte nevojë, kurse ministrat dhe ministritë u zhdukën. Aty nuk kishte dëshirë të punonte më njeri. Të gjithë po kërkonin një vend pune ku mund t'i diskutojnë problemet dhe përvojat e njëri-tjetrit në atmosferë të mirë, me dashamirësi dhe duke buzëqeshur. Fillimisht shkuan të punonin në bujqësi, ndërtim dhe pastrim publik, sepse në të vërtetë nuk dinin të bënin gjë tjetër.

Parlamenti përbëhej prej 12 vetësh. Secili përfaqësonte nga një muaj, edhe atë në punë sociale. Nuk kishte shumë zyrtarë. Ata u quajtën *përgjegjësit* e vendit.



# SHESHI KOSSUTH

Përgjegjësi i mjekësisë popullore merrej më tepër me ripërgatitjen e mjekëve dhe që shumica e spitaleve të specializojë për pushimin pas ditës SË SUKSESSHME të rojes së natës.

Përgjegjësi i kulturës **Adolf F. Posa** merrej me rikonstruktimin e televizionit hungarez.

Kanali NATURE-MIN; Transmetonte pamje tronditëse rreth mbeturinave, leshterikëve, midhjeve dhe karkalecave të detit.

Programi i Norbi-t; Përveç pirjes së forever lite ultra-s dhe freedom-it

duhet të shtriheshe për të kapur ndonjë garcinia plus që rrokullisej!

U rikthye Ariu i Televizorit; i cili mësoi fëmijët të lahen me sapun aloe dhe të lajnë dhëmbët me pastë dhëmbësh aloe. U bënë plotësime, sepse ai vetëm bënte gargarë dhe përtypte. Nuk pështynte. Donim t'i harronin plotësisht vitet 3/3.

Në kuzhinën e Stihl-it; mësuam si të gatujmë mish me acide Iyrose Omega 3 dhe Omega 9.

Programi i kulturës së shtëpisë; na mësoi se - Si t'i tapetojmë me propolis muret me gëlqere?

Lajmet televizive si fillim folën për rrëmujat svicerane. Donin të bashkoheshin me çdo kusht me Hungarinë, por Austria ishte në gadishmëri dhe nuk e lejoi. I mbylli kufijtë. Që dyqanet hungarezë të mos pushtohen nga kapakët sviceranë.

Pastaj riporterit pyeti presidentit e vendit tonë; Ç'do të bëhet pra? – **Sandor**-i u përgjigj i qetë; do të shkojmë në Rally. Fytyra e riporterit u qetësua.

Lajmet vazhduan me problemin më të madh të politikës sonë të brendshme. Nuk po vendosnim dot si ta quajmë urën e 67-të mbi Danub. Por ramë dakort që në linjën Budapest-Debrecen Metroja të mos qëndrojë, dhe pastaj të ndërtojmë një tjetër ndërmjet Budapestit dhe Szolnokut.

Programi i ri me titull GINKGO; prezantoi ish-politikanët që dëshirojnë të mësojnë, të cilët donin ta mbaronin tetëvjeçaren për katër vjet.

Kanali erotik Multi-Maca i solli frytet e tij. Në parqe shikoheshin gjithmonë e më shumë gra shtatzanë. Çdo grua shtatzanë morri si dhuratë kuponin Royal Jelly në varësi të numrit të fëmijëve që do të lindte. U siguria me ligj përdorimi falas i KIDS dhe FIRST.

Mijëra miliard forintat e dedikuara shëndetësisë i investuan për arësimimin e fëmijëve. Morri fund pagimi i pensionit. Asnjëri nuk donte të dilte në pension. Shtetasi hungarez



nga e drejta e merituar e autorit mund të shkojë çdo çerek viti jashtështetit për të pushuar.

Me zhvillimin e shtetit u bëmë me specialistë gjithmonë e më të kualifikuar dhe duhet të pranohet emigrantë nga jashtë. Dhe erdhën nga Svica, Gjermania dhe Holanda. Për këta kishte nevojë, sepse në verë udhëtonte gjysma e vendit. Dikush në male, dikush në bregdet, dhe shumë të tjerë matanë oqeanit. Popullsia e Dubait morri pjesë në një kurs intensiv për të mësuar gjuhën hungareze që t'u shërbejnë edhe më mirë turistëve hungarez.

Përgjegjësi i çështjeve të jashtme; Lenkei nuk ishte pa punë. Sipas shembullit të Disneyland-it pranë aeroportit të Ferihegy-it ndërtoi një kopje të parlamentit, - duke shmangur kështu trafikun e rënduar të kryeqytetit gjatë pritjes së ministrave të jashtëm që vinin në vendin tonë, të cilët sillnin me vete specialistë ekonomie, investitorë dhe shpeshherë edhe spiunë industrie, të cilët studionin se si do t'i paguajmë të gjitha borxhet.

Por kishte punë edhe përgjegjësi i çështjeve të brendshme. Pas ditëve tona të suksesit ata që hidhnin sa andej-këtej kutitë e xheleve i dënoi me dy ditë *trajtim Liciumi* në burgjet vendase wellness.

Policia hungareze nuk kishte shumë punë. Ajo rekrutoi shumë femra të reja. Edhe pajisjet e tyre përbëhen vetëm nga një spray me emrin aktivator me përbajtje 99,8% aloe të filtruar, i cili duke u spërkatur në sy në fillim të djeg, por pastaj të siguron kënaqësinë e shikimit të pastër.

U bëmë vendi i Safirëve dhe Diamantëve. Gazetat merreshin gjithmonë e më shumë me borxhet e të kaluarës të Robi V.-s, të cilat ai i tregoi vetë në konferencat e shtypit. Periudha heroike – thotë mjeshtri – kur organizoja 1/1 nga kabina telefonike në minus dhjetë gradë vetëm me një xheketë të hollë. Sot është një nga investitorët më me influencë të USA-s. Që kur bleu pronën e Bill Gates-it e stakon me më vendosmëri laptopin e tij.

Po BURSA! Gjithë bota i ndjek me vëmendje ndryshimet e BUX-it hungarez! Në Hungari derdhen burime nga çdo vend i botës! TVSH-n e fshinë. Taksa vjetore e të ardhurave personale është 5%. Dhe kjo vetëm pas kualifikimit si Supervisor!

OPEC-i është e shqetësuar për zhvillimet shkencore në Hungari. Rafineria e naftës në Szazhalombatta nuk punon më. Makinat dhe termocentralet e rinj, si dhe aeroplanët punojnë me çaj aloe të eksperimentuar nga kërkuesit tanë, i cili është i përdorur por mund të ripërdoret i paketuar në filtra.

Edhe industria farmaceutike ndryshoi shumë. Disa fabrika u përpoqën t'i fallcifikonin produktet Forever, por shumica prodhuan sapun, shampo dhe xhel dushi aloe me paketimin e tyre individual.

Turizmi morri përmasa të pabesueshme. U hapën vende argëtimi, restorante, teatre, të cilat u mbushën me shikues hungarez dhe të huaj. Sheik arab, të pasur amerikanë, njerëz të famshëm pushtuan Budapestin dhe zonat e tjera të

Hungarisë. Brad Pitt bleu shtëpi në Nogradmegyer, Michael Jackson e zbardh veten në banjot me avull të hoteleve Probiotic në Hajduszoboszlo.

E quajmë një sukses të madh në fushën e diplomacisë sportive faktin se mund të përgatitemi për në Lojrat Olimpikë si *vend organizues*. Kemi edhe skuadër futbollit e cila përgatitet për finalen e kampionatit botëror në Tata. Në radhët e hungarezëve luanin Ronaldinho, David Beckham, Rooney, të cilët pas stërvitjes hodhën kërkesën për lejeqëndrim në Hungari.

Pas kampionatit botëror ata do të stërvisin djemtë hungarez për në kampionatin e ardhshëm.

Sigurisht! Tani jam ulur në kopshtin e pallatit Csürke dhe nga filxhani im ndihet era e çajit aloe. . . . . Por çfarë ndodh? Për një moment më zbehet shikimi. Është tym! Geza ndezi cigaren? Zgjat dorën për Vision-in, por nuk mund t'i lëviz dot duart, njerëz me bluza të bardha më prekin pulsën dhe një doktor që vjen erë duhani më bën kompresë në kokë, të cilën e godita në një shtyllë elektrike përpara skenës.

Dalëngadalë ngrihem në këmbë, hedh një sy rrotull dhe shikoj vetëm bar të shkelur, shishe dhe bishta cigaresh të hedhura. Përsëri në realitet. Nuk e di ç'drejtim të marr, ku doja të shkoja, vetëm eci sa andej këtej. Harrova edhe emrin tim. Rastësisht fus dorën në xhep ku gjej një kartë; Lajos Turi, manager, 360-000-464-899, FLP. Tani e di se ku ndodhem, në ç'drejtim dhe përse u nisa. Drejt jush!

**BENCE NOGRADI**

lektor biznesi (Afrika e Jugut)

**Që kur ekziston sistemi MLM debatohet që duhet shitur apo jo në këtë biznes?! Meqë marrëveshja për shumë njerëz është puna më e vështirë në botë, madje sipas disave edhe të mësosh të ngasësh helikopter është më e lehtë, këtë “anë të errët” të ndërtimit të biznesit përpiqemi ta përmirësojmë ose të mos flasim më për të. Prandaj të interesuarve na pëlqen t’u themi se “këtu nuk duhet shitur!” ose “nuk bëhet fjalë për shitje klasike”.**

*Pjesë nga manuali network marketing me titull Kur do të bëhesh Milioner? II që u publikua jo shumë kohë më parë, pjesa e parë e të cilit në 2005-ën arriti numrin më të madh të kopjeve të shitura në tregun hungarez të librave të biznesit.*

*Me autorin e tij mund të kontaktoheni në adresën e-mail [milliomos@milliomos.hu](mailto:milliomos@milliomos.hu) ose në faqen e internetit [www.nogradibence.hu](http://www.nogradibence.hu).*

# Këshilla për Suksesin

## Çfarë duhet të dijë për shitjen një ndërtues rrjeti

**E**vërteta është që: distributori i zgjuar “nuk merret me shitjen e produkteve”, por “informon të tjerët rreth ekzistencës së produkteve”. Prandaj për ndërtimin e një rrjeti me të vërtetë nuk nevojiten aftësi lidhesh biznesi apo komunikimi, siç nuk është e rëndësishme as që ndërtuesi i biznesit të dijë përmendësh teknikat e shitjes si bilanci-Columbo, bilanci-Benjamin Franklin apo bilanci-Hruscsov.

Por sistemi multi-level marketing është një METODË TREGËTIMI, thelbi i të cilës është i njëjtë prej gjashtëdhjetë vitesh:

- 1) Anëtarët e rrjetit i përdorin produktet e kompanisë.
- 2) Anëtarët e rrjetit i rekomandojnë ato në rrethin e të njohurve të tyre dhe për këtë marrin shpërblim.
- 3) Një pjesë të blerësve u lind dëshira për ndërtimin e biznesit dhe drejtuesit që ndodhen mbi ta në strukturën e biznesit shpërblehen edhe në bazë të *rendimentit* të tyre.

Sado e çuditshme, kompania i paguan distributorët në bazë të *qarkullimit të produkteve*.

Vështirësia e vërtetë fillon kur nga tre njerëz duam të bëjmë qarkullimin që

mund të bëhet nga tridhjetë njerëz. Dhe çuditëmi kur ata tre njerëz nuk dëshirojnë më të na dëgjojnë as zërin në telefon. Sepse e dinë: nëse na dëgjojnë ne në telefon, ata duhet të paguajnë.

Në kurset tona përgatitore takohem shpeshherë me ndërtues rrjeti të cilët përpiqen prej vitesh të bëjnë përpara, por nuk dinë as të pyesin, as të lënë takim dhe as të rekomandojnë. Këta njerëz nuk janë të pasuksesshëm sepse nuk kanë aftësi apo “nuk kanë lindur për MLM”, por sepse *asnjëherë nuk u kanë mësuar bazat e shitjes*.

Në shumicën e rrjeteve mundësitë e mbijetesës së bashkëpunonjësve tanë fillestarë përmirësohen shumë nëse në vend që ta fshehim temën e debatit rreth shitjes, t’i sqarojmë gjërat që në fillim: “Zonja dhe Zotërinj! Lajmi është i vërtetë — një pjesë e biznesit tonë është shitja. Dhe prandaj duhet ta theksojmë që në fillim mësimin e bazave të shitjes. . .”.

Natyrisht, mos kujto se po flas për një kurs shitjeje tre ditor! Në fillim mjafton nëse fillestarëve u mësojmë gabimet kyresore që mund të kryejë ndërtuesi i rrjetit gjatë shitjes.

1. Nëse duhet ta përkufizoj në një fjali atë që ia vlen të dish rreth shitjes, atëherë kjo do të ishte: ÇDO SHITËS FLET SHUMË!

Kjo është e vërtetë edhe për drejtuesit e rrjetit. Baza e çdo shitjeje është të dëgjojmë se çfarë dëshiron klienti, pastaj t'i japim *pikërisht* atë që do. Nga ana tjetër çfarë bën një rrjetndërtues i zakonshëm kur takohet me një blerës potencial? Shpjegon pa pushim! E mbulon tjetrin me produkte.

Klientët na kërkojnë shpesh që tregëtarët tanë mbi të gjitha t'i mësojmë të trajtojnë pretekstet. Në këtë rast e shpjegoj gjithmonë se aftësia më e rëndësishme e një shitësi është **TEKNIKA E TË PYETURIT**. Në trainimet e shitjes kohën më të shumtë e shpenzojmë për të mësuar se si t'u bëjmë pyetjet e duhura klientëve tanë.

Sepse nëse bën pyetje të duhura në fillim të bisedës, atëherë më vonë nuk ke nevojë të trajtosh pretekste.

2. Përveç fjalëve të shumta gabimi tjetër i zakonshëm në shitje bëhet kur në takimin e caktuar me blerësin e planifikojmë më parë se çfarë produkti duam t'i shesim.

Një nga shkaqet e kësaj është se për këtë produkt marrim shpërblimin më të madh (psh. në rastin e sigurimeve), ose në rrjet përhapet se cili është "produkti më popullor", dhe prandaj të gjithë këtë rekomandojnë. Rezultati i këtyre takimeve "të paraplanifikuara" është që rrjetndërtuesi **NUK DËGJON** se çfarë thotë klienti, prandaj takimi shpeshherë përfundon në mosmarrëveshje. Pikërisht në ditët e kaluara u takova me një "këshilltar të

ruajtjes së shëndetit". Më kot i thashë tre herë se përse kam nevojë, ai prapë u përpoq të më mbushte mendjen për blerjen e një produkti që i tejkalonte nevojat e mia. (Siç u morr vesh më vonë, sepse nga ai produkt kishte shumë në magazinë. . . ) Çuditësh që nga një tregëtar i tillë blerësi largohet me duar në kokë?

Sipas Zig Ziglar, një nga tregëtarët më të mëdhenj amerikan, çdo shitje ka pesë pengesa: s'ka nevojë, s'ka para, s'ka nxitim, s'ka dëshirë, s'ka besim. Unë do të shtoja edhe një të gjashtë: kur s'ka klient!!!

3. Mos e ngatërro ndërtimin e biznesit me shitjen e drejtpërdrejtë!

Shumica e rrjetndërtuesve e shmangin shitjen. Të tjerë kalojnë

në ekstremin tjetër: ka nga ata që përqëndrohen *vetëm* tek shitja dhe bëjnë një qarkullim të pabesueshëm duke punuar vetëm. Më kujtohet një nxënësja ime të cilën e quaja: *nëna trime*. Është një tregëtare këmbëngulëse. Po të jetë në "moment të mirë" është e aftë të shesë për një muaj një milion e gjysëm shami. Por duke mbajtur pesëmbëdhjetë prezantime në javë sa kohë i mbetet për ndërtimin e skuadrës? Dhe sa bashkëpunonjës të saj do të jenë të aftë ta realizojnë këtë rendiment çnjerëzor. . . ? Kjo metodë nuk mund të ndiqet nga të tjerët.

Shitja është pjesë e ndërtimit të biznesit, por thelbi qëndron në vetë emrin e tij: erdhëm të *ndërtojmë biznes*, dhe jo të shesim.



4. Detyra e parë e fillestarit: kërko blerës!

Nga ana tjetër, meqë rreth shitjes nuk flasim me gjithë qejf, shumë fillestarë përqëndrohen që në fillim tek ndërtimi i biznesit dhe kërkojnë vetëm “managerë”. Meqë fjalëkalimi i biznesit është ndjekshmëria, gjithë skuadra ndjek shembullin e drejtuesit. Kështu lindin skuadrat me qindra njerëz që mezi bëjnë qarkullim, ku asnjëri nuk konsumon apo shet, por vetëm qëndron dhe pret që dikush “nën të” të fillojë të punojë.

Prandaj gjëja e parë që duhet të bëjë një fillestar (menjëherë pas shkrimit të listës së emrave): të gjejë *dymbëdhjetë blerës të përhershëm* të cilët në çdo muaj blejnë rregullisht produkte prej tij. Në shumicën e rasteve për mbledhjen e blerësve mjafton që njerëzit të dijnë rreth *ekzistencës së produkteve*. Si ndërtues biznesi detyra jote kryesore nuk është shitja e produkteve, por të gesh njerëzit të cilët kanë nevojë për ty! Prandaj e them vazhdimisht në trainime që në ndërtimin e biznesit kryesorja nuk është teknika e komunikimit, por promovimi apo reklamimi i vetvetes (dhe i produkteve).

Duhet të arrish që çdo njeri në mjedisin tënd rrethues ta dijë se kur të ketë nevojë për plotësues ushqimor, atëherë këto tek ty i gjen shpejt, me cilësi të mirë dhe çmim korrekt.

5. Në mbyllje duhet ta pyesim blerësin që: ju **nevojitet** apo jo?

Sipas përvojave të mia shkak i të paktën pesëdhjetë përqind i shitjeve të porealizuara është tepër i thjeshtë: tregëtari nuk e pyeti asnjëherë klientin që *a dëshiron të blejë?!*

Qëndron përballë të njohurit tënd, i prezantove produktin (ose në rastin e ndërtimit të biznesit mundësinë e biznesit) dhe tani vjen momenti kur duhet të hidheni në sulm, i cili në këtë rast do të thotë nënshkrimin e formularit të porosisë ose të regjistrimit.

Pra, duhet ta mbyllësh me rezultat takimin!

Shumë tregëtarë kanë frikë nga refuzimi ose nuk e besojnë se blerësi dëshiron të blejë me të vërtetë, prandaj e vazhdon informimin dhe në një farë mënyre “e bindin” blerësin të mos blejë. Për ta shmangur këtë gabim, LUTJU KLIENTIT QË TË VENDOSË!

Në çdo situatë shitje për mbylljen me sukses nevojiten tre gjëra:

- 1) momenti i duhur (njohja e shenjave të blerjes)
- 2) pyetje përmblyëse efektive
- 3) mos u nervoz!

Gjëja e parë që duhet të bësh është krijimi përpara i disa *pyetjeve përmbledhëse*. Praktikoi këto derisa të jesh në gjendje t’i thuash “pa nervozizëm” sikur po pyet dikë që a kërkon një filxhan me çaj. Mos ki emocion! Më e shumta do të thojë që tani nuk i intereson kjo gjë. Atëherë çfarë bëhet? Sipas rregullave me këtë arrite një hap më afër atij që pastaj do të thotë: “Po!”

6. Ajo që s’duhet të harrosh të kërkos K-U-R-R-Ë!

Arritët ta mbyllni shitjen? Shkëlqyeshëm! Dhe tani do të largoheshë që klienti të mos ketë mundësi të ndryshojë mendjen. Por kur ta bësh këtë të vijë ndër mend që unë jam pranë teje duke të tërhequr vërejtje. Nuk ke harruar ndonjë gjë? Si jo! Të kërkos rekomandime!!!

Shitjen mund ta konsiderojmë të përfunduar nëse arritëm të sigurojmë emrin dhe numrin e telefonit të disa personave të cilët gjithashtu mund të kenë nevojë për produktet. Kërkimi i rekomandimeve në të vërtetë është shumëherë më i thjeshtë se sa e mendojnë shumë vetë. Në shumicën e rasteve nuk marrim rekomandime, SEPSE NUK KËRKOJMË REKOMANDIME!

Nga çdo kandidat (blerës) largohu duke siguruar të paktën tre emra dhe numra telefonash të të njohurve të tij, pavarësisht se shite apo jo.

Nëse ndryshe nuk e mban mend, atëherë tako sinjalin e zgjimit në celularin tënd që të kujtojë që: duhet të kërkos rekomandime! (Kur isha tregëtar fillestar përpara takimeve shkruaja gjithmonë në dorë fjalën “Rekomandime!”. Klientët natyrisht e shikonin dhe më pyesnin se çfarë është. Dhe kur hapej tema ishte më e thjeshtë të kërkoje rekomandime!)

U shfaq me lejen e autorit.  
Duke zbatuar çdo të drejtë  
© Rhino Training Kft. 2006.  
www.milliomos.hu.



**KRISZTINA EDIT KALMAR**  
manager

**Me respekt të madh dëshiroj të falenderoj të gjithë ata që më shoqëruan në këtë rrugë, linjat e mia të sipërme, Jozsi dhe Marika Szabo-n, Dr. Sandor Milesz-in, dhe linjat e mia vëllazërore, të cilët më mbështetën duke ma forcuar vazhdimisht besimin se jam në gjendje ta ndërtoj këtë biznes.**

# Çfarë do të bëje po

**D**ëshiroj të falenderoj në mënyrë të veçantë skuadrën e frontit prej pesë supervisorësh: **Dori Szabo-n, Marta Szócs-in dhe Arpi Lipcsei-n, Zsuzsi Schalk Szabolcsikne-n (DM Zsuzsi ☺), Zsolti Fitt-in, Lajos Csavas-in dhe Judit Bekker Pappne-n, gjithë skuadrën e Martfú-s, si dhe Attila Domjan-in dhe skuadrën e tij**, që patën besim tek unë që jemi në gjendje ta bëjmë së bashku! Tani është radha Juaj!!!

la di shumë për nder **sponsorit tim Miki Berkics-it**, i cili edhe në momentet më të vështira më nxorri jashtë hidhërimit, më mbështeti dhe më dha besim vazhdimisht.

Falenderoj Zotin që më mbajti në këtë rrugë dhe më drejton me mençuri!

JETA më vuri në provë edhe mua! Por *pengesat ekzsitojnë që t'i kapërcejmë.* Të dashur Miqtë e mi! Mos kini frikë nga vështirësitë që ndodhen përpara jush! Të gjithë duhet ta gjejmë rrugën në labirintin e jetës, dhe duhet t'i arrijmë pikësynimet tona edhe mes ndryshimeve. *Ne përgjigjemi për lumturinë tonë!*

Po i shkruaj këto rreshta që t'iu jap besim dhe forcë Juve që të rrëzoni muret e ndërtuar rreth vetes suaj, që të bëheni të shëndetshëm, të kënaqur, dhe ta besoni se: **e meritoni lumturinë!**

Kërkimi i rrugës sime filloi në të njëjtën kohë me ndryshimin e sistemit. Në

fillim të karrierës sime si arësimtare gjithçka filloi plot me entuziazëm, ëndrra dhe një martesë. Që të realizonim qëllimet tona dhe të mund të planifikonim familje, hymë në një biznes gjelash deti. S'e imagjinoni dot se ç'do të thoshte gjithë kjo! Paradite jepja mësim në Pecs (sepse unë jam vajzë nga Pecs), kurse nga pasditja deri të nesërmen në mëngjes merreshim me gjela deti 40 km larg nga Pecs.

10 000! Pra dhjetë mijë gjela deti të vegjël. Ngrënie, pirje, pastaj përsëri ngrënie, pirje. Kur mbaronim në ndërtesën e fundit të fermës, e fillonim nga e para në ndërtesën e parë. Ngrënie, pirje, ngrënie, pirje. Për muaj të tërë kështu kalonte çdo ditë. Flija shumë pak. Shpendët tashmë nuk ishin më të vegjël. Por qëllimet më shtynin përpara. Mund ta bëj! Do ta arrij! Pastaj në një ditë të ftohtë dimri, kur gjelat e detit ishin rritur dhe hanin mirë, meqë nuk kishim qenë jashtë asnjë natë, iu lutëm partnerit tonë që vetëm atë natë të kujdesej për shpendët. Dhe atëherë nuk e dinim se me këtë po shkojmë drejt dështimit tonë. Atë natë dritaret mbetën hapur dhe shpendët u ftohën. Dhe brenda dy javësh ngordhën të gjitha. Dhjetë mijë shpendë të ngordhura.

Kisha lexuar diku që "përshtatu shpejt me ndryshimin"! Unë atëherë nuk u përshtata dot. U shkatërrova.

Thosha me vete se *baza e jetës është pavarësia. Qëllimi i jetës është kënaqësia. Rezultati i jetës është zhvillimi.*



# të mos kishe frikë...?

Pra, përpara. E mbloodha veten dhe thashë: *let's go!*

Në fillim të viteve 90, kur lindën edhe fëmijët e mi të mrekullueshëm, edhe unë u preka nga era e tregëtisë së rrjetit. Investova shumë para dhe kohë në mësim. Kisha një drejtues të shkëlqyer. Dëshiroja të dija gjithçka rreth funksionimit të MLM-s. Mësova shumë, lexova çdo libër që gjendej në këtë periudhë, morra pjesë në çdo kurs, dëgjova shumë kaseta, por më mungonte diçka. Në vetvete. Atëherë nuk e njihja akoma fjalën e urtë:

**nëse e mposht frikën, atëherë bëhesh i pavarur!** Nëse do të dish se si mendon, atëherë shiko se si jeton! Dhe nëse do ta ndryshosh jetën tënde,

duhet të ndryshosh vetëm mendimet e tua! Urra! Kjo është zgjidhja!

Pra dola përsëri nga zhgënjimi im. Filluam një biznes pranë dy fëmijëve të vegjël. Për fat të keq përsëri me një "partner". Krijua një Shoqëri Shkolllore që funksiononte në gjithë vendin, ku morra pjesë në mënyrë aktive. Zona ime ishte në jugperëndim të Danubit dhe rrethi Zala, Győr-Moson-Sopron, Vas, dhe Komárom. Udhëtime të shumta, përgjegjësi e madhe. Pas një periudhe të vështirë dy vjeçare – fëmijët e mi i shikoja pothuajse vetëm në fotografi – kur puna e rrjetit filloi të ecte, kuptova se nuk ndodhem në vendin e duhur. E keni parasysh "gjëja e përbashkët". U

ngrita dhe dola jashtë zyrës. Kur do të marrë fund kërkimi i rrugës? Miqtë e mi u përpoqën të më ndryshonin mendjen. "Mos e shkatërro veten!", "Ti punon më shumë se tre njerëz të tjerë së bashku!" – më thanë.

Edhe familja ime u përpoq të m'i fshihte ëndrrat poshtë qilimit. Por nuk u dorëzova! Ndërkohë u ktheva të jepja mësim, shikoja me vëmendje dhe i jepja besim vetes me bindje gjithmonë e më të madhe: *Mirëqenia është një gjendje e natyrshme!* Këtë e meritoj edhe unë!

Motoja ime ishte që *është më mirë të kërkosh në labirint sesa të qëndrosh në një vend pa Djath.* Nëse ecën në drejtim



*të ri, mund të gjesh lehtë Djath të Ri.*  
Prandaj ndryshova drejtim. Kisha besim se ka zgjidhje!

Duhet të ketë! Dhe shkova mëtej. Derisa më 15 gusht 1995 u largua njeriu i vetëm i cili më pranoi ashtu siç isha, i cili kishte besim tek unë, dhe i cili më donte më shumë se çdo gjë tjetër në botë – Babai im. “Njeri! Lufto dhe beso!” Përsëri në tokë. Dhe përsëri duhet të ngrihesh! Përsëri dhe përsëri.

Vendosa. Dëshiroj të merrem me diçka që i shërben shëndetit. I premtova vetes dhe Zotit se nuk do të lë të vdes asnjëri në mjedisin tim pa bërë gjithçka që mundem për ta ndihmuar atë.

Përsëri MLM. Pra, kjo është rruga ime? A është kjo ajo që dëshiroj prej kohësh? Bimë mjekësore dhe multi-level-marketing. Urra! Shpëtuam!

Në janar 1997 fillova të ndërtoj rrjetin dhe caktova si qëllim që më 27 gusht të po atij viti ta realizoj. Dhe e realizova. Në vitin e ardhshëm në skuadrën time vinin vazhdimisht

managerët e rinj. Por s’ ishte gjithçka e lehtë. Një rrugë plot me rreziqe në Amerikë, sëmundje e rëndë, pastaj një ndarje. Biznesi nuk mbeti i imi. Stand up! Deri kur? Më dukej se nuk kisha më fuqi. Por me falje sistemi ynë imunitar bëhet më i fortë. Dhe unë u bëra gjithmonë e më e fuqishme.

E kuptova: *duhet të ndryshoj.* Sepse ai që nuk është i gatshëm të ndryshojë, përfundon si dinosaurët! Erdhi përsëri shkolla. (Për fat të mirë më pëlqen të jap mësim!) Pastaj në ditën e fundit të mësimin, e cila ishte një ditë sporti, në një ndeshje futbollit më shtynë dhe pësova një dëmtim të rëndë në kokë me humbje kujtese.

*Më kot: Zhvillimi është i pafund!*

Jetë e re, punë e re. U punësova në institucionin kryesor financiar të Hungarisë dhe më përgatitën si këshilltare investimesh. Ndërkohë u njoha me produktet e FLP-s, (edhe me këtë rast falenderoj shumë **Istvan Hajdu-n dhe Eszter Hegyi-n**) por biznesin nuk e dëshiroja. E dija se produktet ishin fantastike, pasi kisha edhe vetë përvoja, por mendova se

për biznesin “nuk kisha kohë”. Në bankë punoja 10–12 orë në ditë, por të paktën kisha para për të jetuar. Të rrisësh dy fëmijë vetëm, nuk është një ëndërr! Në fillim punoja në rajonin jugperendimor të Danubit, pastaj më vendosën në Budapest. Fëmijët e mi në Pecs, kurse unë në Budapest. Shkoja sa andej këtej për tre vjet. Nuk ishte e lehtë! Fëmijët qanin në shtëpi, kurse unë në punë. Por duhet të shkoja. Duhet ta bëja. Pasoj një periudhë e re shtrëngimi dhëmbësh. Shkoja dhe e bëja, sepse kisha një qëllim! Më saktë dy. Doja një apartament dhe një makinë që t’u siguroja një jetë më të lehtë dhe të lumtur fëmijëve të mi dhe vetvetes. E arrita. Më në fund! Të paktën diçka!

FLP-ja më afrohej gjithmonë e më shumë. Në vjeshtën e 2002–shit Forever organizoi një konkurs bukurie ku një shoqja ime dërgoi fotografinë time. Eliminatore, gjysëmfinale, pastaj më 16 nëntor finalja në Pallatin e Kongreseve. Në mes të mbëmjes doja të shkoja në shtëpi. Çfarë kërkoj unë këtu? – pyeta vetveten. Por **Judith Müller** “më zuri në arratisje e sipër”. Qëndrova. Ishte një mbresë e çuditshme, mund t’iu tregoj shumë rreth asaj se çfarë ndodhi në atë mbrëmje! (☺) Dhe prapë një falje – në këtë rast do të thoshte që të vemë re ditën e perëndisë tek secili – pavarësisht nga mënyra se si sillet.

Dalëngadalë erdhi KOHA. Në nëntër të 2005–ës **Miki Berkics**-i më tha se “kishte ngritur nga varri” një nga linjat e mia të vjetra assistant supervisorit në Budapest dhe që ka edhe një vend në makinën e tij për në Success Day-n e ardhshëm. E lashë veten të ma hidhnin. Dhe shkova. Ky ishte vendimi më i mirë



i jetës sime! Për hobi kisha marrë pjesë në shumë aktivitete të FLP-së, por atëherë, aty më preku diçka.

Më 19 nëntor 2005, në atë sallë të lojrave me dorë vendosa: **UNË TANI DO TA REALIZOJ KËTË!!!** Forever Living Products dhe unë lidhëm martesë deri sa të jemi gjallë.

Në dhjetor **Miki** udhëtoi, dhe gjatë kësaj kohe unë mësova. Bëra gjithçka që më tha! Gjithçka! Sponsori është Njeriu tek i cili mund të besosh me mijë përqind! Ai është për ty. Punon për suksesin tënd. **Beso tek sponsori yt! Dhe beso tek vetvetja!** Unë e dija se çfarë dëshiroja. E di Lexuesi i Dashur se çfarë i caktova vetes si pikësynim? Që më 27 gusht të bëhem managere. Historia përsëriti vetveten. E arritëm! Pa **Mikin** nuk do ta kisha arritur dot! Falenderimi im për të nuk mund të shprehet me fjalë. Edhe gjatë këtyre tetë muajve më dolën përpara shumë pengesa. Që në janar më thyen makinën dhe më morrën çantën time të FLP-s. Brenda kisha listën e emrave. Disa ditë më vonë policët e gjetën në një kopsht. Mungonin CD-t, DVD-t, por hajdutët kishin lenë brenda thesarin më të shtrenjtë – listën time të emrave. (Çfarë fati!)

Në shkurt përsëri aksident, por tani patëm fat. Të paktën ne pasagjerët, sepse makina ime të cilën pikërisht një muaj më parë e pagova plotësisht, u shkatërrua totalisht.

Për muaj të tërë shkoja në punë me miqtë–bashkëpunonjësit e mi. S'kishte ndalesë.

Në maj më operuan ngrënien e kërcit të gjurit që pësova nga një dëmtim i vjetër sporti. Po atë muaj në Budapest ishte Success Day. 10 ditë pas operacionit, me paterica, por morra pjesë. Nuk bëhej fjalë që të shkoja apo të mos shkoja. Në korrik – gusht e planifikova nivelin e managerit. Punova shumë. **Miki** "harroi" të më thoshte që ta mendoj edhe njëherë, sepse në mes të verës njerëzit janë me pushime. . .

Por ndërkohë e kuptova edhe vetë. Nuk kishte rrugë kthimi. E dija mirë se ky është biznes. Dhe suksesi dhe paraja nuk vjen automatikisht. Morra një vendim dhe doja ta ndërtoja. Më ndihmuan edhe linjat e mia të Budapestit, dhe sponsori më qëndroi pranë deri në fund. "Më futi" në makinën e tij, patericat prapa dhe shkuam. Pecs–Budapest, Budapest–Pecs. Në rrugët e mira hungareze shpeshherë përtpypja lotët që më dilnin nga dhembja (që Ai të mos i shikonte), por shkonim. Shkonim nga java në javë.

E ndjeja që tani do ta arrija! Pavarësisht se ndërkohë m'u godit përsëri makina. Tani ishte në gjendje të ecte, por prapë. Fala përsëri. (Aq më tepër se ishte Sponsori im i Dashur ai që nuk më vuri re dhe më erdhi prapa. 😊😊) Mendova se s'ka problem derisa goditet vetëm makina.

Pra, ja ku jemi tani. Më 22 gusht i bëmë 120 pikët. Muajin e mbyllëm me 137 pikë. Falenderoj edhe njëherë Skuadrën dhe **Miki Berkics**-in që më qëndruan pranë në të mira e të këqija, më ndihmuan në këtë rrugë të bukur, por me pengesa, të cilët patën besim dhe më bënë të besoja që së bashku jemi të aftë për mrekullira!

**Po Ti, Lexuesi im i Dashur? A e beson se je i aftë për mrekullira?**

**Çfarë do të bëje po të mos kishe frikë?**

Një mesazh nga A. J. Cronin:  
*"Jeta nuk është një korridor i drejtë që mund të shihet mirë, ku mund të ecim të lirshëm, pa asnjë pengesë, por një labirint rrugësh, në të cilin me kërkim të gjatë dhe të vështirë duhet të kërkohet rrugën, dhe ndërkohë herë pas here përfundohet në rrugë qorre. Por nëse kemi besim, na hapet gjithmonë një derë – ndoshta jo pikërisht ajo që prisnim, por me çdo kusht ajo pas të cilës na pret rruga e duhur."*

**Ngrihu vetëm njëherë më shumë se sa herë re në tokë! Dhe fitorja do të jetë e Jotja! Eja me ne dhe bëhu i pavarur! Bashkohu me fitimtarët, sepse jeta e fitimtarëve është një jetë dinamike. Një jetë e cila është gjithmonë plot me lumturi!**

lu bekoftë Zoti!

## S H T Y P I

**Botuese:** Kompania Forever Living Products, Hungari.

**Redaktoi:** FLP Magyarország Kft. 1067 Budapest, Szondi u. 34. Telefon: (36-1) 269-5373 Fax: (36-1) 312-8455

**Redaktori kryesor:** Dr. Milesz Sándor

**Redaktor:** Kismárton Valéria, Petrőczy Zsuzsanna, Pósa Kálmán, Rókás Sándor

**Përgatitja për shtypje:** Tipofill 2002 kft.

**Grafika:** Teszár Richárd, Buzássy Gábor

**Shtypi:** Veszprémi Nyomda Zrt. **U përgatit** në 49 250 kopje

Për përbajtjen e artikujve shkruesit mbajnë përgjegjësi! Çdo e drejtë mbrohet!

**Përkthyes, redaktues:** *shqip:* Dr. Marsel Nallbani – *kroat:* Darinka Aničić, Anić Antić Žrako

– *serb:* Tóth-Kása Otília, Molnár Balázs, Meseldžija Dragana – *sloven:* Novak Császár Jolanda, Eurotranslate Ljubljana



# Forever Living Products Hungary



FOREVER  
**Aloe 2Go**™



ALOE VERA ANTIOXIDANT FORMULA  
LIQUID DIETARY SUPPLEMENT

3 Fl. Oz. (88.7 ml)

FOREVER®